



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:262454

Datë: 11.05.2021

Numri i dokumentit: 01772239

AA.nr.102/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1498/2016, të datës 30.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1498/2016, i datës 30.11.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1498/2016, të datës 30.11.2020, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit PSH.nr.134/16,137/16 dhe 138/16 i datës 22.09.2016. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, Dibran Zogaj - Koordinator për çështje juridike, SHSKUK, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i ankimuar pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ndryshohet dhe të aprovohet padia e paditësit SHSKUK, si e bazuar dhe të lëshohet aktgjykim meritor lidhur me këtë rast.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH.nr.134/16,137/16 dhe 138/16 të datës 22.09.2016, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, i është shqiptuar gjobë autoritetit kontraktues Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) në shumë prej 25,000.00€ (njëzet e pesë mijë euro), për mos zbatim të urdhëresës së panelit shqyrtues, me nr.134,137,138/16 të datës 17.08.2016, siç parashihet në nenin 131 të LPP-së. Në pikën II të dispozitivit të vendimit, është obliguar, autoriteti kontraktues Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK), që gjobën e lartcekur ta paguajë në afat prej 15 ditëve, në xhirollogarinë e OSHP-së, nr.1000 4300 7000 5756 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 30.09.2016, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se vendimi kontestues me të cilin paditësit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 25,000.00€ (njëzet e pesë mijë euro) është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore, respektivisht në pajtim me nenin 131 të Ligjit nr.04/L – 042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Andaj gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe ligjit material, kur ka shqiptuar dënimin me gjobë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkellje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkellje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar nenit 131 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, me të cilin përcaktohet se “OSHP-ja do të vendosë një gjobë për jo më pak se 5.000 (pesë mijë euro), për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mos respektimin e urdhërit të OSHP-së brenda 5 ditëve”. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar nenit 44 për Ndërprerjen e Procedurave të Prokurimit, të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), me të cilin përmenden arsyet e ndërprejes së aktivitetit të prokurimit, pas marrjes së ofertave, pas hapjes së ofertave. Ndërsa me paragrafin 4.12 të të njëjtës dispozitë përcaktohet se “Pavarësisht nga ajo që është cekur më sipër, AK do të anulojë një njoftim për dhënie të kontratës, nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, rekomandohet nga

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik apo në përputhje me paragrafin 10.2 të nenit 108/A të LPP-së. Në një rast të tillë AK do të përgatisë njoftimin e anulimit të dhënies të kontratës të cilën e dërgon në KRPP për publikim dhe do tu dërgojë njoftimin për anulim të gjithë OE që kanë treguar një interes në aktivitetin e prokurimit.”

Po ashtu, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, shihet se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar pretendimet e paditësit, sipas të cilit: e paditura nuk ka mundur të bëjë zbatimin e vendimit të OSHP-së me nr.134,137,138/16 të datës 30.06.2016, për të vazhduar me procedurën e mëtutjeshme me nënshkrimin e kontratës për aktivitetin e prokurimit “ Pastrimi i hapësirave të brendshme spitalore” me nr.prot. 202/16/2011 për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore për implementimin e kontratës pasi që gjatë periudhës së realizimit të aktivitetit të prokurimit të këtij procesi kanë ndryshuar rrethanat për sa i përket mjeteve buxhetore të planifikuara për këtë aktivitet. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të paditësit, mirëpo të njëjtat me të drejtë i ka konsideruar si të pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike, kjo për faktin se nga procesverbali i takimit të mbajtur në datë 16.05.2016 në zyrën e BD të SHSKUK-së vërehet se në takim kanë prezentuar përfaqësuesit e të gjitha njësive përbërëse të SHSKUK dhe atë të Spitalit të Gjilanit, Gjakovës, Vushtrrisë dhe Shëndetit mental në Shtime, ku është analizuar çështja e njoftimit për dhënien e kontratës të datës 03.05.2016 si dhe disponueshmërisë që kanë programet buxhetore që ishin pjesë e tenderit “Pastrimi i brendshëm i hapësirave të objekteve spitalore”, ku është nxjerrë si konkludimi se çdo njësi-program buxhetor që është pjesë e këtij tenderi të dërgoj me shkrim mundësitë financiare për nënshkrimin e shumave që duhet kontraktuar. Kështu që paditësja përkundër konkludimit të tillë nuk kishte paraqitur si provë në gjykatë asnjë raport ose çfarëdo dëshmie që do të paraqiste mundësitë financiare të njësive përkatëse për zbatim të kontratës në fjalë.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë për bazë faktet dhe provat e prezantuara të palës paditëse se është ofruar material i mjaftueshëm mbi atë se moszbatimi i vendimit të OSHP-së, është ardhur si pasojë e kufizimit të buxhetit apo zvogëlimin e buxhetit prej 1,750,914.00€ gjykatës i kemi bërë të ditur se SHSKUK si organizatë buxhetore nuk ka kod buxhetor as buxhet vetanak në nivel qendror. Pastaj se, kemi ofruar fakte të mjaftueshme me anë të të cilave është arsyetuar mjaftueshëm se ekzekutimi i vendimit të OSHP-së mund të afektohet drejtpërdrejt tek nevojat për shërbime ndaj pacientëve që nënkupton se, ekzekutimi i vendimit të OSHP-së ndikon drejtpërdrejt në interesin publik pasi që ka të bëjë me shërbimet që i ofrohen pacientëve të Republikës së Kosovës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes kolegji i

kësaj gjykate gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se paditësja po të njëjtin vit kur ankohej për zvogëlim buxheti dhe kishte përdorur të njëjtin justifikim në rastin e mos nënshkrimit të kontratës, bordi i saj kishte nxjerrë vendimin nr.80,81,82,83/16 të datës 04.10.2016 me të cilat kishte aprovuar kërkesat e njëjësive përbërëse të SHSKUK për nënshkrimin e kontratës dhe autorizojë kryesuesi i këtij bordi për nënshkrim të kontratës “Pastrim i brendshëm i hapësirave të objekteve spitalore lot 1, 2, 3, dhe 4”. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se vendimi kontestues me të cilin paditësit i është shqiptuar dënim me gjobë është i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore, përkatësisht në pajtim me nenin 131 të Ligjit nr.04/1-042 për Prokurimin Publik.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë fare faktin se vazhdimi me aktivitetin e prokurimit lidhur me nënshkrimin e kontratës “Pastrimi i brendshëm i hapësirave të objekteve spitalore” si S.P. Gjilan lot 2, S.P.Vushtrri lot 3, QIRKSP – Shtime lot me numër identifikues 220-16-001-211 bie ndesh me nenin 26 par.4 nën par. 4.2 të Ligjit për Prokurim Publik me nr. 05/L-68. Ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykimi i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.102/2021, me datë 19.04.2021

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi

Numri i lëndës: 2019:262454
Datë: 11.05.2021
Numri i dokumentit: 01772239